

PERCEPTIMI I TË RINJVE DHE TË REJAVE PËR BALLKANIN E HAPUR



KONGRESI
RINOR
KOMBËTAR



PERCEPTIMI I TË RINJVE DHE TË REJAVE PËR BALLKANIN E HAPUR

Nëntor 2022



AUTOR:

Dr. Armela Pengili
Msc. Eridjona Vallja



© Aplikimet për leje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky publikim duhet të dërgohen në:

ACT for SOCIETY

Rr: “Bulevardi Bajram Curri”; Nd.280; H.5; Ap.4, Tiranë

Email: info@actforsocietycenter.org

Website: <https://www.actforsocietycenter.org/>

Ky dokument është realizuar në kuadër të programit Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022 me mbështetjen financiare të Kongresit Rinor Kombëtar në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi ACT for SOCIETY dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Kongresit Rinor Kombëtar apo Bashkisë Tiranë.

Rreth nismës së Ballkanit të Hapur



Nisma për krijimin e Ballkanit të Hapur ose njohur ndryshe si Mini-Schengen synon përmirësimin e marrëdhënieve politiko-ekonomiko mes vendeve të rajonit.

Planet për krijimin e Ballkanit të Hapur u deklaruan për herë të parë në takimin e mbajtur më 10 tetor 2019 në Novi Sad të Serbisë. Më 29 korrik 2021 në Ohër, kryeministri i Serbisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut nënshkruan marrëveshjen për liberalizimin e qarkullimit të mallrave, unifikimin e tregut të punës dhe bashkëpunimin kundër katastrofave. Deri tani pjesë e kësaj iniciative janë bërë Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Ndërsa Kosova, Mali i Zi dhe Bosnjë Hercegovina kanë hezitur t'i bashkohen.

“Ballkani i Hapur” është një nismë bashkëpunimi mes tre vendeve të rajonit, Shqipërisë, Maqedonisë së veriut dhe Serbisë, e cila synon të zbatojë sa më shpejt në rajonin e Ballkanit Perëndimor, katër liritë e BE-së; lëvizjen e njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit. Qëllimi përfundimtar i nismës është t'u mundësojë vendeve të rajonit të hapin kufijtë e tyre për të lehtësuar jetën e qytetarëve dhe komunitetit të biznesit. Në kuadër të bashkëpunimit rajonal dhe në përputhje me planin e përbashkët të tregut rajonal të procesit të Berlinit, nisma nuk është kundërshtuar nga SHBA dhe BE.

Për të përmbushur objektivat e vendosura, “Ballkani i Hapur” ka zhvilluar punën përmes seancave ku janë nënshkruar marrëveshjet mes tre shteteve anëtare.

- Në takimin e parë u ra dakord që qytetarët të udhëtojnë me letërnjoftim të vlefshëm deri në vitin 2021, të mund të punojnë kudo në rajon dhe t'u njihen diplomat në të gjithë rajonin. U ra gjithashtu dakord të rritet bashkëpunimi kundër krimit të organizuar dhe që vendet të ndihmojnë njëri-tjetrin për t'iu përgjigjur fatkeqësive natyrore.

- Më 10 nëntor 2019, në fokus të takimit ishte lehtësimi i lëvizjes së mallrave dhe qytetarëve. Pandemia ndërpreu takimet për shkak se gjatë vitit 2020, palët nuk mundën të takoheshin fizikisht, ndaj zgjodhën t'i bënin takimet online.
- Në takimin e parë fizik pas lehtësimit të masave nga Covid- 19, në korrik 2021 në Shkup, u prezantua emri i ri i iniciativës. Nga “Balkan Mini-Shengen” nisma trepalëshe do të quhej “Ballkani i Hapur”. Në këtë takim, të tre liderët nënshkruan disa marrëveshje të cilat parashikojnë që gjatë vitit 2023 lëvizja e qytetarëve dhe mallrave të bëhet e lirë dhe pa pengesa mes Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut. Marrëveshja tjetër e bazuar në axhendën e gjelbër ka të bëjë me mbrojtjen dhe shpëtimin nga fatkeqësitë natyrore në Ballkanin Perëndimor. Në këtë takim u ra dakord për lëvizjen e lirë në tregun e punës ndërmjet vendeve duke ofruar leje pune për qytetarët që duan të punojnë në këto vende.
- Në dhjetor 2021, Shqipëria priti vendet e Ballkanit Perëndimor, por vendet e përfshira në iniciativë mbetën të njëjtat, pasi Kosova, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi refuzuan t'i bashkoheshin nismës.
- Vendet e Iniciativës për Ballkanin e Hapur kanë nënshkruar gjithsej 9 marrëveshje lidhur me mobilizimin e të tre vendeve për përballimin e fatkeqësive natyrore; për të lehtësuar importin dhe eksportin e mallrave; akses të lehtë në tregun e punës dhe marrjen e lejeve të qëndrimit; për identifikimin elektronik të qytetarëve të Ballkanit Perëndimor; për bashkëpunim në fushën e mjekësisë veterinare, sigurisë ushqimore dhe ushqimit të kafshëve në Ballkanin Perëndimor; për bashkëpunim në fushën e akreditimit në Ballkanin Perëndimor.



Të rinjtë dhe të rejat në Ballkanin e Hapur



“Ballkani i Hapur” është mundësi dhe perspektivë për të ardhme të sigurt të të rinjve dhe të rejave në rajon

Ndërtimi i besimit të ndërsjelltë është i domosdoshëm që Ballkani të jetë i dëshirueshëm për jetesë nga të rinjtë dhe të rejat.

Në këtë perspektivë, bashkëpunimi mes vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, si dhe lidhja mes të rinjve dhe të rejave të këtyre shteteve paraqitet me një rëndësi të veçantë. Shkëmbimi i përvojave, projekteve, aktiviteteve, njohurive, informacioneve janë themelore për rritjen e besimit tek të rinjtë dhe të rejat, si dhe ndërtimin e një të ardhme të sigurt në Ballkan. Por shtetet duhet të tregohen të kujdesshme dhe të maturuara në hapat e ndërmarra për këtë nismë, që ka si synim final hapjen e kufijve të vendeve të rajonit për të lehtësuar jetën e qytetarëve dhe komunitetit të biznesit.

Rinia është pjesa më vitale e shoqërisë, që prek target grupin e shkollës së mesme, universitetit dhe hyrjes në tregun e punës. Në këto kushte, nisma të tilla duhet të kenë ne fokus ofrimin e shërbimeve dhe mundësive të ndryshme për të rinjtë dhe të rejat, për të dhënë kontributin e tyre të vyer në shoqëri. Që të rinjtë dhe të rejat të investohen dhe të investojnë në shoqëri, duhet që shteti të ndërmarrë politika të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare që synojnë garantimin e mundësive të ndryshme për zhvillimin e potencialit të tyre.

Qendra ACT for SOCIETY në zbatim të projektit “Open Balkan Cities”, në kuadër të programit Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022 me mbështetjen financiare të Kongresit Rinor Kombëtar në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, ka realizuar një anketim me të rinjtë dhe të rejtat e Ballkanit Perëndimor, me qëllim matjen e perceptimeve të tyre mbi Ballkanin e Hapur, avantazhet dhe disavantazhet e tij.

Gjetjet nga anketimi me të rinjtë dhe të rejtat në lidhje me perceptimin e tyre për Ballkanin e Hapur, përshkruhen në sesionin e analizës.



PERCEPTIMI I TË RINJVE DHE TË REJAVE PËR BALLKANIN E HAPUR



1500 të rinj dhe të reja të grupmoshës 15-29 vjeç, nga vendet e Ballkanit Perëndimor janë anketuar.



Prej muajit shtator 2022



Deri në muajin tetor 2022


Shtetësia e të rinjve dhe të rejave të anketuar

Kosova (88) Maqedonia e Veriut (105)




Serbia (105)

Shqipëria (1244)




90% e të rinjve dhe të rejave të anketuar jetojnë në zonat urbane, ndërsa 10% e tyre jetojnë në zonat rurale.



15-18 vjeç 19-24 vjeç 25-29 vjeç


1019 (68%) e të rinjve dhe të rejave kanë qenë vajza, përkundrazi 444 (29%) të rinjve dhe të rejave kanë preferuar të identifikojnë gjendjen e tyre.



Shumica e të rinjve dhe të rejave të anketuar ishin gjimnazistë (607 të rinj dhe të reja, 40%), ndjekur nga grupmosha e të rinjve dhe të rejave në universitet dhe në hyrjen në tregun e punës (523 të rinj dhe të reja, 35%) dhe nga grupmosha e të rinjve dhe të rejave në punë (370 të rinj dhe të reja, 25%).

Gjimnazistë
40%





Perceptimet e të rinjve dhe të rejave për Ballkanin e Hapur janë vlerësuar nëpërmjet pyetjeve të ndryshme të hapura dhe të mbyllura të një pyetësi, i aksesuar online (nëpërmjet google form).

1 në 4 të rinj dhe të reja nuk ka njohuri për Ballkanin e Hapur (25% e totalit të të anketuarve). Nga analiza e të rinjve dhe të rejave që nuk kanë njohuri për këtë nismë, rezulton se masa më e madhe e tyre janë gjimnazistë (grupmosha 15-18 vjeç).

1 në 4




Nga analiza e shteteve, rezulton se ky raport është më i lartë në Maqedoninë e Veriut (1 në 5 prej të rinjve dhe të rejave të anketuar), ndjekur nga Shqipëria me raportin 1 në 3.

1 NË 4 TË RINJ DHE
TË REJA NUK
KANË NJOHURI
PËR NISMËN E
BALLKANIT TË
HAPUR

Instagrami është burimi kryesor që të rinjtë dhe të rejat marrin informacion për tematika të ndryshme, ndër të cilat dhe për Ballkanin e Hapur (në masën e 42% të të anketuarve), ndjekur nga faqet zyrtare (27%), Facebook (19%), televizioni (11%) dhe LinkedIn (2%).

Një ndër çështjet e tjera të konstatuara tek të rinjtë, përpos informacionit të kufizuar që kanë, si dhe jo shumë mjeteve në dispozicion për t'u informuar mbi nismën e Ballkanit të Hapur, është **mospjesëmarrja e tyre në aktivitete** që vendi i tyre duhet të organizoj për të rritur nivelin e informimit tek komuniteti mbi nismën e Ballkanit të Hapur. Në këtë aspekt, afërsisht 1 në 5 të rinj dhe reja, nga kampioni i të anketuarve, kanë marrë pjesë në aktivitete të realizuara në vendin e tyre për nismën e Ballkanit të Hapur.

Nga analiza e shteteve, rezulton se të rinjtë dhe të rejat që shprehen të kenë marrë pjesë në aktivitete të tilla, janë nga Shqipëria.




VETËM 1 NË 5 TË
RINJ DHE TË
REJA KANË
MARRË PJESË NË
AKTIVITETE TË
REALIZUARA NË
VENDIN E TYRE
PËR BALLKANIN
E HAPUR

Shumica e të rinjve dhe të rejave (39%) mendojnë se **qëllimi kryesor i nismës së Ballkanit të Hapur është rritja e mundësive dhe perspektivës për të ardhme të sigurt të të rinjve në rajon.**

Nga analiza e shteteve, këtë mendim e kanë shprehur masivisht të rinjtë nga Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria. Ndërsa pjesa më e madhe e të rinjve nga Serbia mendojnë se qëllimi kryesor i nismës së Ballkanit të Hapur është lëvizja e lirë e mallrave, shërbimeve dhe njerëzve në Ballkanin Perëndimor.

Shumica e të rinjve dhe të rejave të anketuar (58%) mendojnë se **nisma e**



- Përmirësimi i marrëdhënieve politiko-ekonomike mes vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor
- Lëvizja e lirë e mallrave, shërbimeve dhe njerëzve në Ballkanin Perëndimor
- Liberalizimi i tregjeve të punës, duke krijuar më shumë mundësi për qytetarët dhe duke e bërë rajonin më tërheqës për investimet e huaja
- Zgjerimi i listës së shërbimeve që mund të ofrohen elektronikisht për qytetarët në rajon
- Rritja e mundësive dhe perspektivës për të ardhme të sigurt të të rinjve në rajon

Shumica e të rinjve dhe të rejave janë në dijeni se kjo nismë ka dakordësimin e Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Europian

68%

Ballkanit të Hapur sjell direkt përfitime për të rinjtë dhe të rejtat. Ky besim është më i lartë në radhët e të rinjve dhe të rejave të Maqedonisë së Veriut (80%), ndjekur nga Kosova (75%), Serbia (67%). Të rinjtë dhe të rejtat nga Shqipëria janë më skeptikë për përfitimet që kjo nismë sjell tek ata (1 në 2 të anketuar shprehen se nuk ka përfitime).

ASPEKTET NEGATIVE TË NISMËS (RISQET) NË SYTË E TË RINJVE DHE TË REJAVE

Përpos efekteve pozitive që nisma e Ballkanit të Hapur mund të sjell për të rinjtë dhe të rejtat, shumë prej tyre listojnë një sërë efektesh negative. Në totalin e të anketuarve, më shumë se 1 në 3 të rinj dhe të reja (38%) shprehen se **nisma mund të rrisë më tej ndarjet rajonale dhe atyre që mbeten jashtë iniciativës**. Ky besim është më i thellë në radhët e të rinjve dhe të rejave nga Shqipëria (42%).

Shumica e të rinjve dhe të rejave nga Serbia (67%) dhe Kosova (50%) mendojnë se **nisma rrezikon të zëvendësojë qëllimin e Tregut të Përbashkët Rajonal, i cili është pjesë e Proçesit të Berlinit.**


Shumica e të rinjve nga Maqedonia (60%) mendojnë se **nisma mund të sjell efekte negative në bashkëpunimin e mirëfilltë ndërmjet vendeve.**

KUTIA 1
5 EFEKTET
NEGATIVE QË
NISMA MUND
TË SJELL

- Nisma mund të rrisë më tej ndarjet rajonale dhe atyre që mbeten jashtë iniciativës (38% e të rinjve dhe të rejave të anketuar).
- Nisma rrezikon të zëvendësojë qëllimin e Tregut të Përbashkët Rajonal, i cili është pjesë e Proçesit të Berlinit (25% e të rinjve dhe të rejave të anketuar).
- Nisma mund të sjell efekte negative në bashkëpunimin e mirëfilltë ndërmjet vendeve (19% e të rinjve dhe të rejave të anketuar).
- Nisma rrezikon rrugën e këtyre shteteve në Bashkimin Europian (16% e të rinjve dhe të rejave të anketuar).
- Tjetër (3% e të rinjve dhe të rejave të anketuar).


Shumica e të rinjve dhe të rejave (57%) shprehen se **heqja e kontrolleve kufitare mund të përkeqësojë trafikun e drogës dhe aktivitete të ndryshme kriminale.** Ky besim është më i konsoliduar në radhët e të rinjve dhe të rejave kosovarë (75%) dhe shqiptarë (56%).

SFIDAT PËR
REALIZIMIN E
NISMËS JANË TË
SHUMTA.



RRJETËZIMET MES TË RINJVE DHE TË REJAVE MUND TË HAPIN MENDJEN DHE TË THYEJNË BARRIERAT E KRIJUARA NDËR BREZA

Pothuajse 1 në 3 të rinj (30%) dhe të reja janë pjesë e rrjeteve, grupeve të të rinjve.



Mekanizmat e antarësimit në grupe të tilla janë të ndryshme, por kryesisht të rinjtë dhe të reja janë antarësuar:

- Nëpërmjet institucioneve/ organizatave që kanë realizuar aktivitete për shkëmbim eksperience/ rrjetëzim me të rinjtë
- Nëpërmjet praktikave mësimore në vendet e rajonit
- Nëpërmjet miqve/ familjarëve

Antarësimi në grupe të tilla mund të shërbejë për njohjen më të mirë të kulturës së vendit, duke thyer barrierat që mund të ishin krijuar ndër breza.



REKOMANDIMET PËR BALLKANIN E HAPUR




Më shumë informacion dhe transparencë mbi rolin e të rinjve dhe benefitet që mund të sjell Ballkani i Hapur tek të rinjtë

Takime periodike me grupe të ndryshme interesi për nismën e Ballkanit të Hapur

Informim dhe ndërgjegjësim në media për publikun e gjerë

Të rinjtë të jenë prioritet në nismën e Ballkanit të Hapur

Ndërmarrja e politikave konkrete për të krijuar një dialog afatgjatë dhe të strukturuar ndërmjet të rinjve të Ballkanit Perëndimor



1. TRANSPARENCË PËR NISMËN E BALLKANIT TË HAPUR

Qeveritë që e kanë përkrahur dhe nënshkruar marrëveshjen për nismën e Ballkanit të Hapur, duhet të jenë transparente në shpërndarjen e informacioneve tek publiku i gjerë. Një informacion më i detajuar dhe i qartë duhet të jepet në lidhje me aktorët përgjegjës për zbatimin e nismës, buxhetin përkatës për zbatimin e saj, si dhe nëse është formuar komisioni i parashikuar në marrëveshje për zbatimin e kësaj nisme.

2. PËRFSHIRJA E TË RINJVE

Qeveritë që e kanë përkrahur nismën, duhet të kenë në fokus përfshirjen direkte të të rinjve dhe të rejave, për të qenë më të informuar për nismën, si dhe për të hartuar politika që kanë në fokus prioritetet e të rinjve dhe të rejave. Shkëmbimi i përvojave, projekteve, aktiviteteve, njohurive, informacioneve janë themelore për rritjen e besimit tek të rinjtë dhe të rejat, si dhe ndërtimin e një të ardhme të sigurt në Ballkan.



3. SHKËMBIMI KULTUROR BREDA RAJONIT

Qeveritë duhet që nismën e Ballkanit të Hapur ta shfrytëzojnë si një mundësi të mirë për shkëmbimin kulturor brenda rajonit, duke njohur sfidat e përbashkëta, njohjen me njëri-tjetrin dhe përmirësimin e marrëdhënieve mes qytetarëve dhe rritjen e lëvizshmërisë falë lehtësive që do t'u ofrohen vendeve të Ballkanit Perëndimor.

4. THYERJA E PARAGJYKIMEVE/ STEREOTIPEVE

Qeveritë e vendeve që kanë nënshkruar nismën, mund të thyejnë paragjykimet dhe stereotipet ndërmjet vendeve, në saj të rritjes së lëvizshmërisë në rajon duke i bërë njerëzit që të udhëtojnë pa pengesa, të eksplorojnë dhe mësojnë për njëri-tjetrin.

QEVERITË DUHET
TË JENË
TRANSPARENTE
NË SHPËRNDARJEN
E
INFORMACIONEVE
PËR BALLKANIN E
HAPUR TEK
PUBLIKU I GJERË

